



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0020730-2/26 dt. 20.04.2026  
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0020730/26, dt. 16.04.2026, të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Kryetari i Komunës sjell këtë:

## V E N D I M

### (Për formimin e Komisionit për hartimin e Draft – Rregullores Komunale për Transport në Qytetin e Mitrovicës së Jugut)

- FORMOHET** Komisioni për hartimin e Draft – Rregullores Komunale për Transport në Qytetin e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
  - 1.1 Fatime Hyseni – kryetare (DSHPI);
  - 1.2 Fisnik Ibrahim – anëtar (DSHPI);
  - 1.3 Gjylferije Ademi-Kadri – anëtare (DSHPI);
  - 1.4 Rexhep Hajdari – anëtar (DSHPI);
  - 1.5 Bedri Muja – anëtar (DI);
  - 1.6 Ardian Brahimi – anëtar (DPU);
  - 1.7 Naser Shala – anëtar (DBF).
- Komisioni është përgjegjës që të bëjë hartimin e Draft - Rregullores për Transport në Qytetin e Mitrovicës së Jugut, duke përfshirë të gjitha propozimet nga drejtoritë komunale që implikohen në zbatimin e saj, dhe të bëjë harmonizimin e tyre me dispozitat ligjore pozitive në fuqi.
- Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për Shqyrtim dhe Miratim përmes Kryetarit të Komunës.
- Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi obligohet që të hartoj Draft-Rregulloren në afat më së largu brenda 6 (gjashtë) muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

**Shtojcë:**

Propozim-Vendimi Nr. 01-020/04-0020730/26, dt. 16.04.2026, i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë.

**T'i dërgohet:**

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

